



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

**Vendim**

**Nr. 34 Date 22/09/ 2017**

**Për**

**Dhënie mendimi për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike për HEC "Bardhgjana", Lumi Fan i Vogël / Subjekti "A & S-04 Albania shpk dhe Ulza-Ndërtim " shpk.**

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore", nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015,"Per miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni"(i ndryshuar), me propozim të A.B.U. Mat, **Këshilli i Basenit Ujor Mat,**

**Vendosi:**

1-Miratimin në parim të kërkesës së "A & S-04 Albania shpk dhe Ulza-Ndërtim " shpk, me Administrator Z. Simon Lala dhe z. Nikolin Shpani , për "Përdorim Rezerva Ujore për Energji Elektrike" sipas studimit të paraqitur nga subjekti "A & S-04 Albania shpk dhe Ulza-Ndërtim " shpk, me këto të dhëna:

**HEC "BARDHGJANA"**

Rrjedha e lumit Fan i Vogël,degë e lumit Fan, të Bashkisë Mirditë, Qarku Lezhë.

-Prurja mesatare :  $Q= 5.98 \text{ m}^3/\text{sek}$ ,

-Prurja llogarites:  $Q= 7.0 \text{ m}^3/\text{sek}$ ,

-Prurja ekologjike:  $Q= 0.26 \text{ m}^3/\text{sek}$ ,

-Prurje për përdorime të tjera: \_\_\_\_\_  $\text{m}^3$

-Energjia e planifikuar vjetore:  $7\ 994\ 265$  kwh/vit,

-Fuqia 2000 kw.

-Kuota e veprës së marrjes Z- 412 m, X- 44 26 942.88 Y-46 40 053.72

-Kuota e godinës së centralit: Z-378.7m. X- 44 26 529.89 Y- 46 39 881.76

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes,i furnizimit me ujë të popullatës etjere nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËRSGJEGJËSI I A.B.U. MAT**

Ast **NIKOLLA**



**KRYETARI I K.B.U. MAT**

**Eduard NDRECA**

